

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. D., nga Prishtina të cilin e përfaqëson av.Xh. B., nga Prishtina, kundër të paditurit Spitali "H." në Gjakovë, të cilin e përfaqëson H. B., respektivisht av.T. B. nga Gjakova, për shkak të kompensimit të pagave, duke vendosur sipas revizionit të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2211/2015 datë 13.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6.02. 2017, mori këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2211/2015 datë 13.10.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2211/2015 të dt.13.10.2016 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.24/12 dt.4.12.2014,me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar i padituri t'i paguajë shumën prej 13.500,00€ në emër të tri pagave të papaguara për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2011 për çdo muaj nga 4.500 €, me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së padisë 9.01.2012 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 809 €, krejt në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor i padituri ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet revizioni i të paditurit dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Themelore në Gjakovë të prishen dhe çështja t'i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në revizion ka paraqitur paditësi nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që revizioni të refuzohet dhe të mbeten në fuqi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i të paditurit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me padi ka kërkuar që të detyrohet i padituri Spitali "H..." me seli në Gjakovë, që paditësit t'ia paguajë tri pagat e papaguara, në shumën e sipërpërmendur. Paditësi me të paditurin ka lidhur kontratën e punës nr. ..., të datës ..., për vendin e punës kardiokirurg me të cilin ishin përcaktuar të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese, për të cilat palët ishin pajtuar. Kontrata e punës ishte lidhur për kohë të caktuar, për periudhën prej 1.10.2011 deri më 31.9.2013. Punë marrësi sipas kontratës do të fillonte punën më 1.10.2011. Me kontratën e punës respektivisht me dispozitat e nenit 4 dhe 5 ishin të përcaktuara detyrat e punës të punësuarit ndërsa me dispozitat e nenit 6 të kontratës ishin të përcaktuara obligimet e punëdhënësit si: t'i siguroj të punësuarit mjete për punë sipas standardeve minimale të ofrimit të mbrojtjes dhe sigurisë së të punësuarit në punë, të respektojë orarin e punës së të punësuarit, të kryejë pagesën mujore më së largu deri më datën 5 të muajit vijues etj. Ndërsa, me nenin 11 është rregulluar paga – rroga ku kontraktuesit ishin pajtuar që lartësia e pagës për të punësuarin, këtu paditësin të jetë në vlerë prej 4.500 €, ashtu që pas një periudhe kohore në marrëveshje me punëdhënësin lartësia e pagës mund edhe të rishikohet. Me dispozitën e nenit 22 të kontratës së punës po ashtu ishte paraparë hyrja në fuqi e kontratës e cila prodhon efekt juridik në mes të palëve në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese. Kontrata e punës është

nënshkruar nga i punësuar dhe nga punëdhënësi më datë 3.10.2011 dhe e njëjta është vulosur. Nga shkresat e lëndës gjithashtu rezulton se më 5.12.2011 paditësi nëpërmjet postës rekomande i është drejtuar të paditurit që t'i bëjë pagesën e pagës së tij për muajt tetor dhe nëntor 2011 sipas kontratës së nënshkruar. Paditësi po ashtu më datë 13.1.2012 nëpërmjet postës me dërgesë “rekomande” i është drejtuar të paditurit me njoftim se, meqenëse i padituri nuk i ka përmbushur obligimet kontraktuese, i njëjti e shkëput kontratën e punës.

Gjykata e shkallës së parë te kjo gjendje e çështjes ka gjetur se paditësi është paraqitur në punë mirëpo Reparti i Kardiokirurgjisë nuk ishte funksionalizuar. Ajo ka gjetur më tej se kontrata e punës është lidhur në përputhshmëri me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Punës nr. 03/L-2012 dhe përfshinë të dhënat e nevojshme si për punëdhënësin, për të punësuarin, emërtimin, natyrën, llojin e punës, datën e fillimit të punës, kohëzgjatjen e kontratës së punës, lartësinë e pagës etj. Se kontrata e punës ishte e lidhur për një periudhë të caktuar 2 vjeçare nga data 3.10.2011 deri më 31.9.2013. Fillimi i punës ishte data 3.10.2011 kur është nënshkruar kontrata. Po ashtu, ka gjetur se paditësi ka filluar punën ditën e përcaktuar me kontratën e punës ashtu siç parasheh neni 14 i Ligjit të Punës. Se paditësi më datë 2.12.2011 ka kërkuar nga punëdhënësi, këtu i padituri, që t'i bëhet pagesa e pagës sipas kontratës së nënshkruar për muajin tetor dhe nëntor të vitit 2011, ndërsa i njëjti më datën 13.1.2012 e ka njoftuar të paditurin për shkëputjen e kontratës së punës për shkak të mos përmbushjes së obligimeve kontraktuese nga ana e të paditurit. Këtë veprim të paditësit gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar se është plotësisht në përputhje me nenin 69 të Ligjit të Punës i cili parasheh ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga i punësuar. Ajo, po ashtu kishte gjetur se punëdhënësi-i padituri nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për mungesa eventuale të paditësit nga puna apo për shkaqe tjera të përcaktuara me nenin 70 të Ligjit të Punës. Andaj, nga të lartcekurat gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndaj, ka gjetur se ankesa e të paditurit është e pathemeltë dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, kur nga arsyet e sipër theksuara, kanë vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht refuzimin e ankesës së të paditurit. Aktgjykimet e tyre nuk janë të përfshira me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Po ashtu, aktgjykimet e lartcekura, nuk janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që, Gjykatat, kanë pasur parasysh dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës, me të cilat, veç tjerash, parashihet se kontrata e punës duhet të përmbajë emërtimin, natyrën, llojin e punës, llojin e shërbimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës, vendin e punës, orarin e punës, datën e fillimit të punës, kohëzgjatjen e kontratës së punës, lartësinë e pagës bazë etj, gjë që kontrata e punës e lidhur midis këtyre palëve ndërgjyqësore edhe i përmbante, pra, ishte në përputhje me dispozitat e lartë cekura të Ligjit të Punës. Detyrat e punës së të punësuarit, këtu paditësit, si dhe obligimet e punëdhënësit, këtu të paditurit, ishin rregulluar edhe me Kontratën e Punës, dispozitat e neneve 4,5,6,11 etj, e që ishin në përputhje me dispozitat për katse të Ligjit të Punës. Me nenin 22 të Kontratës së Punës parashihej se “Kjo kontratë hyn në fuqi dhe prodhon efekte juridike mes palëve në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese”, e që ishte data 3.10.2011. Sikundër u theksua më lartë, detyrat e palëve kontraktuese, të punësuarit-paditësit dhe të punëdhënësit-të paditurit ishin rregulluar me dispozitat e kontratës, nenet 3,4,5,6,11, që përcaktonin të drejtat dhe detyrat e specifikuara reciproke të tyre. Në mesin e detyrave të punëdhënësit, këtu të paditurit, ishte edhe obligimi i tij që të punësuarit, paditësit, t’i sigurojë hapsir dhe kushtet e punës, t’i sigurojë të punësuarit mjetet për punë, të kryejë pagesën mujore....etj (neni 6 i Kontratës), ndërsa, siç rezulton nga shkresat e lëndës, punëdhënësi këtë nuk e ka bërë. Po ashtu, funksionalizimi i Repartit të Kardio-Kirurgjisë, nuk ishte detyrë e paditësit, të punësuarit, por, obligim i punëdhënësit, të paditurit, gjë që ai nuk e ka bërë. Prandaj, nga këtu, edhe nuk qëndron pretendimi i revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga ana e Gjykatave të instancës më të ulët. Në llogari të këtij konstatimi flet edhe fakti se punëdhënësi, i padituri, ndaj paditësit, të punësuarit, nuk kishte ndërmarrë kurrfarë veprimi lidhur me mos përmbushjen(eventuale) të detyrave të punës nga ana e paditësit dhe ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës, siç parashihet me dispozitat e nenit 70 të Ligjit të Punës, ndërkohë

që, paditësi, për arësyet e sipër përmendura, ka vepruar në përputhje me nenin 69 të Ligjit të Punës, kur ka ndërprerë marrëdhënien e punës në mënyrë të njëanshme.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, poashtu nuk qëndrojnë as thëniet e revizionit për shkeljet nga neni 182.2 pik k) e LPK-së, përkitazi me të paditurin si palë në procedurë, sepse i padituri ka qenë i përfaqësuar në mënyrë të rregullt dhe ka legjitimitet real(pasiv), për të qenë palë në procedurë për faktin sepse i padituri është pjesëmarrës i raportit materialo-juridik nga i cili ka lindur ky kontest juridiko-civil, përkatësisht, ka lidhur kontratën e sipër përmendur të punës me të punësuarin, këtu paditësin, të cilën e ka nënshkruar dhe firmosur, nga e cila kanë derivuar pasojat juridike të sipër cekura.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.361/2016 datë 6.02. 2017

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha
